

NGJITËSIT E PLLAKAVE



ADESIFLEX C2TES1

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë	25 KG	3-5 KG

PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C), me fleksibilitet shumë të lartë (S1), force ngjitëse e përmisuar (2), rezistent ndaj rrëshkitjes (T) dhe me kohë punueshmërie të gjatë (E). Aplikohet për shtresa në trashësi deri në 15 mm. I klasifikuar si ngjitës C2TES1 sipas standartit EN 12004.

FUSHA E APLIKIMIT

I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të mermerit, pllakave të gurit, mozaikëve, tullave të xhamit, pllakave me spesor të lartë në suporte me bazë çimento, për dysheme dhe mure, në ambiente të jashme dhe të brendshme ku ka prani të madhe lagështie. I rekomandueshëm për fasada, tarraca, për ambiente me ngrohje qendrore, për ambiente që janë pjesë e vibrimeve, shtypjeve të vazhdueshme, gjithashtu për ngjitjen e pllakës mbi pllakë (në këtë rast duhet që pllakat të jenë të qëndrueshme dhe të palëvizshme), për ambiente industriale, për suporte të valëzuara dhe të paqëndrueshme (kjo si rezultat i elasticitetit të lartë). I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të formatit 5-200 cm.

SPECIFIKIME

Ngjitës me bazë çimento, i përbërë nga rëra mermeri shumë cilësore me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditivë special të modifikuar. Teknologjia shumë e lartë në shpërndarjen granulometrike dhe përbërësit special i japin këtij produkti karakteristika të shkëlqyera në fleksibilitet dhe punueshmëri, çka e bën këtë ngjitës ideal për ngjitjen e pllakave të mermerit, gurit natyror, granitit, mozaikëve etj (5 -200 cm).

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Përzieni 7-7.5 litra ujë të pastër me 25 kg ADESIFLEX, përzieni masën e krijuar me një përzierës elektrik deri sa të formohet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përziejeni përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë në kushte normale temperaturash (23°C).

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike dhe të sperkatën me ujë.






APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje filmi. Në të kundërt atëherë është e nevojshme që të kalohet dhe njëherë malla mbi kollë. Nuk këshillohet që pllakat të vendosen me fuga të puthitura. Pllakat vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme me dimensionet e tyre. Në sipërfaqjet e bashkimit me muret vertikale duhet lënë një distancë prej 5 mm.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Koha e korigjimit: 35-40 min
Ngjyra: E bardhë	Mbushja e fugave në mure: Pas 8 deri 12 orësh
Konsumi për formate të vogla: 2-3 kg/m ²	Mbushja e fugave në dysHEME: Pas 24 orësh
Konsumi për formate të mëdha: 4-5 kg/m ²	I shkëlshëm: Pas 24 orësh
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Forca ngjitëse pas 28 ditësh: ≥2 N/mm ²
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	FN pas zhytjes në ujë: ≥1.5 N/mm ²
Deformshmëria: S1	FN pas reaksionit nga ngrohja: ≥2 N/mm ²
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa E	FN pas cikleve ngrirje-shkrirje: ≥1.5 N/mm ²
Ujë për përzierje: 7-7.5 litra ujë për 25 kg	FN pas 30 min: ≥0,5 N/mm ²
pH i përzierjes: >12	Rrëshkitshmëria: ≤0,5 mm
Masa vëllimore: 1.65 - 1.75 gr/cm ³	Rezistenca në shtypje: >10 N/mm ²



Kujdes! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përspejtim në tharje të produktit). Për formate pllakash shumë të mëdha, aplikoni shttrim të dyfishtë të kollës në pllakë dhe bazament. Mbroni bazamentin për të paktën 24 orë pas aplikimit të ngjitësit, nga shirat e rrëmbyer si dhe nga ngricat dhe rrezet e forta të diellit. Për formate të mëdha pllakash vendosja e fugës do të bëhet 3-5 ditë pas ngjitjes vetëm nëse është bërë hidroizolimi.